



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.04.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.04.2021, të parashtruar nga 1. Grupi i Operatorëve Ekonomik “D&T group”sh.p.k & “Florida”sh.p.k. & ”Horn”&Co Kosova”sh.p.k dhe 2. Grupi i Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e autorrugëve” – pj.I-rë: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211, nxjerr:

V E N D I M

- II. Refuzohet kërkesat për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve Ekonomik “D&T group”sh.p.k & “Florida”sh.p.k. & ”Horn”&Co Kosova”sh.p.k dhe 2. Grupi i Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com”, të dt. 07.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja e autorrugëve” – pj.I-rë: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211, kundër Njoftimit MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 02.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 02.04.2021;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dorëzohet palëve/

A r s y e t i m

- I. Grupi i Operatorëve Ekonomik “D&T group”sh.p.k & “Florida”sh.p.k. & “Horn”&Co Kosova”sh.p.k dhe 2.Grupi i Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com”, me datë 07.04.2021, kanë parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Mirëmbajtja e autorrugëve** – pj.I-rë: **“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”,** me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

I- Përgjigje për “D&T group”sh.p.k & “Florida”sh.p.k. & “Horn”&Co Kosova”sh.p.k:

Bazuar në raportin e Komisionit të Ri-vlerësimit dt.02.04.2021, „si dhe në Vendimin OSHP-së, me Nr:83,94/21 te dt: 12.03.2021, leshuar nga PANELI SHQYRTUES ju si Grup i Operatorve Ekonomik, nuk keni plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në Dosjen e tenderit, dhe për kë arsye nuk janë dhënë përgjigje pikë për pikë pretendimeve tuaja.

Më poshtë keni disa pika të vendimit të Vendimin OSHP-së:

Lidhur me pretendimin ankimor, se OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë kontratat e punëtorëve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar pasi siç është cekur më lart, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar kontrata pune ose marrëveshje mbi angazhim në projekt.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor të OE ankues N.T.SH "Victory Com" & Company Murseli-Gjakovë, se OE të rekomanduar për kontratë i mungon pjesa e makineri, pastrues të borës mini. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues siç e ka cekur më lart, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi për pastrues të borës mini.

Lidhur me pretendimin ankimor, se OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë kontratat e punëtorëve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar pasi siç është cekur më lart, pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar kontrata pune ose marrëveshje mbi angazhim në projekt.

II- Përgjigje për Grupin e Operatorëve Ekonomik "Murseli Company" shpk & N.Sh.T. "Viktory Com":

Bazuar në raportin e Komisionit të Ri-vlerësimit dt.02.04.2021, si dhe në Vendimin OSHP-së, me Nr:638-645/20 të dt: 19.10.2020, leshuar nga PANELI SHQYRTUES ju si Grup i Operatorve Ekonomik, nuk keni plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në Dosjen e tenderit. Më poshtë keni disa pika të vendimit të Vendimin OSHP-së:

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin ankimor se OE Victory Com ka paraqitur referencë nga kompania Grand Construction në vlerë 150,000€. OE pretendon se kjo referencë nuk ka situacion mbi kryerjen e punimeve, nuk ka fletëpagesa. Theksojmë se për këtë referencë OE ka ofruar kontratën me kompaninë Grand Construcion, mirëpo as në këtë kontratë nuk ka informata, si numri prokurimit, situacionet mbi kryerjen e punimeve, periudha apo përqindja e punëve që është kryer nga OE Victory. Dhe nuk dihet nëse OE është deklaruar si nënkontraktor në kontratën bazë me KK Kaçanik.

Bazuar në këtë që u cek më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK duhet të verifikoj të dhënat e shënuara më lart.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë për referencën e lëshuar nga kompania Gjeo Projekt për largimin e borës dhe shpërndarje të kripës në punishten e kompanisë Gjeo Projekt, të cilën e konteston OE ankues, vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK duhet të kërkojë dëshmi mbi realizimin e këtyre punëve, dëshmi si dëshmi transaksione bankare për pagesat e bëra, pasi kemi të bëjmë me kontratë ne mes të OE-ve privat e të cilat kontestohen nga OE ankues.

I njëjti pretendim ankimorë vlen edhe për referencën e lëshuar nga kompania "Art Konstruktion", nuk ka dëshmi për punët kryera, si fatura, dëshmi për pagesa etj.

Përgjigje në pretendimin nr.5

Lidhur me pretendimin ankimorë sa i përket pajisjeve/makinorisë së OE të rekomanduar për kontratë, OE ankues i referohet vendimit të OSHP-së nr. 939-952/19.

Duhet të theksojmë se me vendim të OSHP-së nr. 933-952/19 në cilin rast OE Victory&Murseli kanë qenë ankues, pretendimi i tyre ankimorë është vlerësuar si i pabazuar sa i përket pajisjeve/makinorisë ashtu siç pretendon tani OE ankues, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Bazuar në Vendimin e OSHP-së, me Nr:638-645/20 te dt: 19.10.2020, Autoriteti kontraktues me dt.30.11.2020, ka kërkuar sqarime shtesë, konform nenit 59 dhe72 të LPP-së, por ju nuk keni ofruar dokumentet e kërkuara(fatura,situacione,transaksione), për këtë arsye nuk janë dhënë përgjigje pikë për pikë pretendimeve tuaja.

Sqarim shtesë për të dy Operatorët ekonomik ankues:

Autoriteti kontraktues sqaron se nuk mund të kërkojen informata sqaruese për Operatorët ekonomik për dokumentet siç janë kontratat e punëtorëve, sepse sipas RRUOPP-ë, neni 39, nuk prezentojnë prova të mjaftueshme për pasqyrim të gjendjes ekzistuese para datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

